

VENDIM
Nr. 220, datë 28.3.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, METODAVE TË TESTIMIT DHE KUFIJTË E
LEJUAR PËR BIODEGRADIMIN E DETERGJENTEVE DHE VLERËSIMIN E RREZIKUT
PËR LËNDËT TENSIOAKTIVE NË DETERGJENTE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 pika 1 të ligjit nr. 10 216, datë 21.1.2010 “Për detergjentet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijve të lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹Ky vendim transponon anekset I, II, III, IV, VIII të rregullores (EC) nr. 648/2004 të Këshillit dhe Parlamentit European, datë 31 mars 2004, për detergjentet, numri CELEX: 32004R0648, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L nr. 104, datë 8.4.2004, faqe 1-35.